

GJL Nr. 101/2012

**GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Mejreme Zekaj kryetare, Dalip Bega dhe Ramiz Kuqi anëtarë, me pjesëmarrjen e Sek. juridike Nexhmije Abazxhik, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga e pandehura Nadire Vitija nga Prishtina, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Nr. regj. 37292/2011 të dt. 23.12.2011, në bazë të nenit 31 al. 3, 39 dhe konform neni 222 të Ligjit mbi kundërvajtjet, më 26.01.2012, merr këtë:

### **A K T V E N D I M**

Ankesa e paraqitur është e **BAZUAR**.

**ABROGOHET** aktvendimi i Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Nr. regj. 37292/2011 të dt. 23.12.2011, dhe lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në plotësim procedure dhe rivendosje.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

### **A r s y e t i m**

**Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë**, sipas aktvendimit Nr. regj. 37292/2011 të dt. 23.12.2011 të pandehurën Nadire Vitija nga Prishtinë, e ka shpall përgjegjës sepse si Drejtoreshë e Bordit në Ndërmarrjen publike Termokosi-Ngrohtorja e Qytetit në Prishtinë, nuk e ka bërë deklarin e pasurisë pranë Agjencionit kundër Korrupsionit në afatin e caktuar ligjor, edhe pse ka qenë e njoftuar se është përfshirë në listën e Zyrtarëve të cilat janë të obliguar të deklarojnë pasurinë me rastin e zgjedhjes së saj në funksionin udhëheqës, më çverim e pandehura ka kryer kundërvajtje nga neni 7 pika 1 lidhur me nenin 16 par. 1 pika 2 të Ligjit për Deklarimin e Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, dhe është dënuar me gjobë në shumë prej 500 (Pesëqind) Euro.

Me të njëjtin aktvendim e pandehura është e obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 5 (pesë) Euro.

Kundër këtij aktvendimi e pandehura Nadire Vitija, ka paraqitur ankesë për shkak të: vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe dënimit për kundërvajtje, me arsyetim se: në faktin se në seancën verbale të mbajtur pranë kësaj Gjykate unë jamë dëgjuar si e pandehur, ku është dëgjuar edhe dëshmitari Nexhmedin Beha, i cili ka deklaruar se njoftimin për deklarin e pasurisë në bordin e drejtorëve e kam bërë në muajin korrik dhe të njëjtën gjoja e ka komunikuar në gusht të vitit 2011, pa i ofruar Gjykatës asnjë provë materiale mbi thëniet e tij. Në këtë drejtim pranë Agjencionit Antikorrupsion e kam deklaruar prejardhjen e pasurisë më dt. 27.10.2011, provë materiale vërtetimi i lëshuar nga Agjensioni Antikorrupsion mbi deklarin e pasurisë i dt. 27.10.2011, këtu edhe qëndron vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike. Sa i përket gjobës së shqiptuar ajo është tepër e lartë. Propozoj që Gjykata e Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, ta aprovoj në tërësi këtë ankesë, ndërsa aktvendimin e Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, ta anuloj dhe ta refuzoj si të pabazë ose të njëjtën ta ndryshoj duke më shqiptuar një gjobë më të butë.

2.

Kolegji vlerësoi thëniet në ankesën e paraqitur, aktvendimin e goditur, si dhe shkresat tjera të lëndës dhe konstatoi se ankesa e paraqitur është e bazuar kurse aktvendimi i goditur abrogohet dhe lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në plotësim procedure dhe rivendosje.

Kolegji pas shqyrtimit të thënieve në ankesë, aktvendimit të goditur, deklarin e të pandehurës Nadire Vitija, të dhënë në seancën e shqyrtimit kryesor pranë gjykatës së shkallës së parë më datë 22.11.2011, deklarata e dëshmitarit Nexhmedin Beha-zyrtar i Termokosit, në procesverbal më datë 22.11.2011 por duke u bazuar edhe në shkresat tjera të lëndës, konstatohej se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave procedurale gjegjësisht të nenit 135 .2 të LK. për shkak se e ka iniciuar procedurën kundërvajtëse dhe ka marr aktvendim duke e shpallur përgjegjëse të pandehurën gjersa kërkesa për hapjen e procedurës kundërvatëse nuk i plotëson kushtet ligjore të cilat janë të parapara sipas nenit 135 .2 të LK; nga se në kërkesë nuk është bërë përshkrimi i fakteve dhe veprimeve nga të cilat rezultojnë tiparet juridike të kundërvajtjes, gjegjësisht nuk është cekur koha dhe vendi i kryerjes së kundërvajtjes si dhe rrethanat tjera të nevojshme që kundërvajtja të përshkruhet në mënyrë më të hollësishme ashtu siç e parasheh dispozita e cituar më lartë. Për kundër kësaj Gjykata e shkallës së parë në bazë të kërkesës së cekur më lartë dhe pas marrjes në pyetje të të pandehurës dhe dëshmitarit ka nxjerr aktvendim me të cilin e pandehura shpallet përgjegjëse kurse në dispozitivin e aktvendimit të goditur gjithashtu nuk janë përcaktuar elementet esenciale të veprës kundërvajtëse dhe nuk është bërë përshkrimi i fakteve dhe veprimeve inkriminuese gjegjësisht nuk është cekur as koha dhe vendi i kryerjes së kundërvajtjes, andaj dispozitivi i aktvendimit të goditur përmban shkelje të nenit 205 al. 1 pika 1 të LK

Përveç kësaj kolegji konstatoj se edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë për shkak se e pandehura në mbrojtjen e vet deklaroj se nuk ka qenë e njoftuar se është e obliguar të deklarohej pasurinë në afatin ligjor kurse dëshmitari Nexhmedin Beha, deklaroi se zonja Vitija ka qenë e njoftuar në muajin korrik të vitit 2011, kurse këtë thot ia kam përkujtuar edhe në muajin gusht të viti 2011 në mbledhjen e Bordit. Duke kundërshtuar deklaratën e Nexhmedin Behës, e pandehura i ka deponuar në gjykatë një numër të procesverbaleve sipas të cilëve nuk figurojnë se ajo ka qenë e njoftuar për obligimin e saj, andaj kjo çështje ka mbetur e pasqaruar dhe si rrjedhojë gjendja faktike e pa vërtetuar në mënyrë të plotë, andaj aktvendimi i goditur si i tillë është i paqëndrueshëm dhe abrogohet kurse lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në plotësim procedure dhe rivendosje.

Në plotësim të procedurës gjykata e shkallës së parë, duhet të kryej këto veprime procedurale: të ftoj parashtruesin e kërkesës dhe ta marr në pyetje dhe me procesverbal ta bëjë plotësimin e kërkesës së parashtruar ashtu siç e parasheh neni 135 al. 2 i LK. pastaj të ftoj të pandehurën dhe dëshmitarin Nexhmedin Beha, dhe të bëjë ballafaqimin në mes tyre në mënyrë që të eliminohen kundërthëniet e paraqitura gjatë procedurës, nëse është e nevojshme të nxjerr edhe prova tjera e varësisht prej asaj se çka ka vërtetuar gjatë procedurës të nxjerrë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në Ligj.

Më sa u tha më lartë në vështrim të nenit 222 të Ligjit mbi kundërvajtjet, u vendos si në dispozitiv.


Kundër këtij aktvendimi nuk ka vend ankesë.

**GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË.**

**GJL. Nr. 101/2012 të dt. 26.01.2012.**

**SEK. JURIDIKE,**

**Nexhmije Abazhik**



**KRYETARJA E KOLEGJIT,**

**Mejreme Zekaj**